17

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

*Nr. 910 Prot.* *Gjirokastër, më: 27 / 07 / 2020.*

# VENDIM
## Nr. 15. Dt. 27. 07. 2020

Bazuar në nenin 6, pika 2, të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër", KIZ

## VENDOSI

1. Fletët e votimit të hedhura në kutinë e gabuar të konsiderohen të vlefshme për aq kohë sa nuk përmbajnë problematikat e përcaktuara në nenin 35, pika 5.
2. Të shënohet në fletoren e procesverbalit të mbledhjeve të ditës së votimit në mënyrë të detajuar përmbajtja e fletës së hedhur në kutinë e gabuar (për cilën kategori dhe kandidat është votuar).
3. Numri i fletëve të hedhura gabim të shënohet në procesverbalin e mbylljes së votimit në zërin "Fletë votimi të hedhura në kutinë e gabuar" pranë autoritetit apo organit drejtues ku duhet të numërohet.
4. Fletët e votimit të hedhura në kutinë e gabuar të futen në zarfin me të njëjtin mbishkrimin, të ruhen me kujdes pranë komisionit dhe t'i bashkohen numërimit për autoritetin apo organin drejtues përkatës.
5. Për t'i dhënë mundësi numërimit dhe pasqyrimit të votave të hedhura në kutinë e gabuar, dokumentacioni mbi rezultatin përfundimtar për secilën kategori të plotësohet në përfundim të procesit të numërimit.

**KRYETARI**
(Emër Mbiemër Firma)
Majlinda Bobrati

**ANËTAR**
(Emër Mbiemër Firma)
Xamira Bobrati

**ANËTAR**
(Emër Mbiemër Firma)

**ANËTAR**
(Emër Mbiemër Firma)

**ANËTAR**
(Emër Mbiemër Firma)